

Mentor Beqa (1981 -). Është doktor i shkencave në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, lektor i teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare, kërkues dhe hulumtues i politikave europiane dhe ndërkombëtare të sigurisë.

Arsimin e mesëm e kreu në shkollën e gjuhëve të huaja “Asim Vokshi” në Tiranë (2000). Studimet e larta i ndoqi në Universitetin e Tiranës në degën e gazetarisë nga ku përfundoi me rezultate të larta (2004). Zoti Beqa është fitues i një burse të qeverisë së Zvicrës ku ka përfunduar studimet master në politikën europiane dhe ndërkombëtare të sigurisë në Universitetin e Gjenevës. Ai ka ndjekur studimet doktorale në Universitetin Europian të Tiranës (2013–2017) ku ka marrë gradën "Doktor i shkencave" në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Zoti Beqa ka punuar si lektor i jashtëm në Fakultetin e Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës (2014–2016). Ai është autor i disa artikujve shkencorë të botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare; po ashtu pjesëmarrës në një sërë konferencash shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në punimet e tij shkencore, ai është përpjekur t'i qaset studimit të politikës së jashtme të Shqipërisë dhe më gjerë pozitës së Shqipërisë në politikën ndërkombëtare, në kuadër të arritjeve më të mira bashkëkohore në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Zoti Beqa ka një eksperiencë të gjatë si gazetar. Ai ka punuar në mediat kryesore të vendit në vitet 2002–2008 duke qenë autori i dhjetëra artikujve dhe editorialeve. Zoti Beqa ka punuar si konsulent për marrëdhëniet me publikun në projekte të Bankës Botërore si *LAMP Project*, implementuar në ZRPP në vitet 2008–2009. Ai është angazhuar edhe në nivele të larta shtetërore si këshilltar i ministrit të Mbrojtjes (2009–2013); drejtor kabineti i Ministrisë së Mbrojtjes (2013); dhe këshilltar i ministrit të Punëve të Brendshme (2017). Në këto funksione ai ka punuar kryesisht me hartimin e politikave strategjike dhe reformat institucionale.

Zoti Beqa ka punuar edhe si drejtues i projektit të kolanës së *Filozofisë Politike*, e cila rendit rreth 60 tituj të veprave më të rëndësishme të mendimit politik të sjella në gjuhën shqipe. Ai ka përkthyer dy autorë të rëndësishëm në studimet politike si Carl Schmitt dhe Friedrich von Gentz.

Zoti Beqa po punon me disa projekte kërkimore që lidhen me mënyrën se si e shkruajmë historinë dhe pjesë të veçanta të saj; pozitën e Shqipërisë në sistemin ndërkombëtar në shekullin e 21-të; procesin e ‘integritit’ Shqipëri-Kosovë dhe problematikën që shfaqet etj.